



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

Fatime Jasiqi,
MASHT
23.01.2015

Qasja qeveritare


- ▶ Republika e Kosovës me institucionet e veta qeveritare dhe joqeveritare po punon në drejtim të rritjes së sigurisë së qytetarëve të vet në nivele dhe rrethana të ndryshme, prandaj për këtë kemi hartuar dhe po i zbatojmë një varg strategjisë nacionale që lidhen me aspektet e sigurisë së përgjithshme, si mund të cekim se MASHT ka hartuar:
- ▶ “ Strategjia dhe Plani I Veprimit për Rritjen Sigurisë në Institucionet e Arsimit Parauniversitar 2014–2019 e cila është dërguar për miratim në Qeverinë e Kosovës, ku në këtë strategji është përfshirë edhe Siguria rrugore, për nxënësit.

Siguria në trafik/rrugë

- ▶ Çështja e sigurisë në trafik është vetëm një nga aspektet, po ashtu të rëndësishme për vendin dhe secili institucion qendror dhe lokal i ka mandatet e veta karshi kësaj fushe

Qasja e MASHT-it

MASHT e ka orientuar punën e vet në tri rrafshe:

- ▶ **në përfshirjen e aspekteve të sigurisë në kurrikula arsimore, të të gjitha niveleve**
 - ▶ **në zhvillimin e aktiviteteve jashtëprogramore në institucione arsimore**
 - ▶ **në koordinimin ndërinstytucional për adresim të sigurisë në rrugë**
- 

Kurrikulat

- ▶ Sa i përket kurrikulave aktuale, temat për trafikun dhe sigurinë në rrugë i kemi prezente te lëndët e Edukatës qytetare, Punëdores, dhe Teknologjisë Mirëpo, tani kur MASHT ka hartuar dhe miratuar Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës dhe Kurrikulat bërthamë për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, si dhe janë në proces kurrikulat për fushat lëndore, presim që të ketë hapësirë më të mirë për temat e sigurisë në rrugë/komunikacion. Gjithashtu, meqë shkollat janë autonome në përzgjedhjen e lëndëve zgjedhore, tani edhe në lëndën zgjedhore presim që ato në mënyrë obligative dhe sipas nevojave dhe interesave të tyre të bëjnë zgjedhjen e temave relevante për sigurinë në trafik.

Aktivitetet jashtëprogramore

Aktivitetet jashtë programore janë të pranishme në shkolla, por që kanë nevojë të zgjerohen edhe më shumë, me qëllim të sensibilizimit të komunitetit shkollor për rolin e institucioneve arsimore në parandalim të rreziqeve dhe aksidenteve në komunikacion.

Bashkëpunimi ndërinstytucional

- ▶ Me synim të forcimit të bashkëpunimit ndërinstytucional, përveç mekanizmave që i drejton Ministria e Infrastrukturës, në mars të vitit 2013 është formuar Forumi për sigurinë në rrugë (FSRr), i cili ka për qëllim që përmes programeve vetëdijesuese (ligjërata, aktivitete garuese në shkolla etj.) të ulë numrin e aksidenteve, që si pasojë kanë humbjen e jetës së shumë pjesëmarrësve në trafik, qoftë ngasës, pasagjerë apo këmbësorë. Ky forum përbëhet nga një numër institucionesh dhe organizatash vendore dhe ndërkombëtare, ndër to edhe MASHT, DKA, Komiteti i prindërve, Këshilli i nxënësve në nivel nacional, mësimdhënës etj. Në kuadër të këtij projekti “Siguria në rrugë”, MASHT i ka caktuar nga një e më shumë shkolla në secilën komunë, të cilat janë përfshirë dhe do të përfshihen në aktivitete vetëdijesuese.
- ▶ Në bashkëpunim me MASHT-in, Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike Tempulli mbajti një Konferencë në MASHT "**Nxënësit dhe siguria e tyre në rrugë**"

Përfundim

MASHT mbetet edhe më tej e përkushtuar në rritjen e koordinimit ndërinstytucional dhe në ushtrimin e rolit të vet në rritjen e njohurive të nxënësve mbi rregullat e komunikacionit, si formë e parandalimit të rreziqeve dhe aksidenteve në rrugë.

Ju faleminderit për vëmendje!